



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 558/4 Prot

Tiranë, më 14.09.2020

V E N D I M

Nr. 90, datë 14.09.2020

Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të ankesës së paraqitur nga nëpunësja ***, për shkelje të të drejtave të nëpunësit civil, përmes cënimit të integritetit fizik, moral dhe dinjitetit, nga ana e drejtuesve të institucionit Agjencia Kombëtare e Turizmit.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimet për shkelje të të drejtave të nëpunësit civil, përmes cënimit të integritetit fizik, moral dhe dinjitetit, të nëpunëses *****,

VËREJ SE:

Nëpërmjet shkresës me nr. 558 prot., datë 23.06.2020 është protokolluar ankesa e nëpunëses *****, përmes së cilës ngrihen pretendime për shkelje të të drejtave të nëpunësit civil, përmes cënimit të integritetit fizik, moral dhe dinjitetit, nga ana e drejtuesve të institucionit Agjencia Kombëtare e Turizmit, të cilat vijnë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi.

Konkretisht, në ankesë parashtrohet se, në datën 18.06.2020, ora 11.32, nëpunësja e Agjencisë Kombëtare të Turizmit, ***** me kërkesën e eprorit direkt, Përgjegjëses së Sektorit, ka dalë jashtë ambientit të institucionit Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe ka takuar këtë të fundit, me të cilën ka biseduar për kryerjen e detyrave funksionale të saj.

Pas takimit, në orën 11.50, nëpunësja është kthyer në institucion por nuk është lejuar të futet në ambientet e punës, në zbatim të urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë, për të mos hapur derën e institucionit. Në këto kushte, duke mos u lejuar të futet në institucion, nëpunësja ka kërkuar disa herë ti jepen sendet personale që kishte në zyrë, në mënyrë që të largohej për në shtëpi, por kërkesat e saj nuk janë marrë parasysh duke keqësuar më shumë situatën.

Në mbështetje të sa më lart, nëpunësja pretendon se, ky veprim nga ana e titullarit të institucionit Agjencia Kombëtare e Turizmit bie në kundërshtim me rregullat e etikës në administratën publike, gjithashtu cënon rëndë të drejtat e nëpunësit civil, të garantuara nga ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në vijim, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me parashtrimin e fakteve të mësipërme dhe me pretendimet e parashtruara nga nëpunësja ***** me shkresën nr. 558/1 prot., datë 02.07.2020, me objekt: “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e ankesës së nëpunëses ******”, kërkoi nga institucioni Agjencia Kombëtare e Turizmit, sqarime si dhe praktikën shkresore që disponojnë për këtë rast, duke përfshirë dokumentacionin që materializon veprimet e kryera nga ana e institucionit.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Agjencia Kombëtare e Turizmit, me shkresën nr. 296/1 prot., datë 06.07.2020, me objekt: “*Kthim përgjigje*”, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 558/2 prot., datë 08.07.2020, ka paraqitur sqarimet si dhe dokumentacionin e kërkuar për rastin në fjalë.

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, gjatë shqyrtimit të përmbajtjes së sqarimeve të dhëna si dhe dokumentacionit të mbledhur gjatë hetimit administrativ, rezultoi se, ***** është punonjëse në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Promocionit*”, Drejtoria e Marketingut dhe Promocionit, në Agjencinë Kombëtare të Turizmit, e emëruar rregullisht, pas kryerjes së procedurës së transferimit të përhershëm për shkak të ristrukturimit, me aktin nr. 3186/2 prot., datë 15.05.2017, të Departamentit të Administratës Publike. Sipas sqarimeve të sjella nga institucioni, kjo punonjëse në datë 18.06.2020, ka dalë jashtë ambienteve të institucionit pa njoftuar dhe pa shënuar në librin e hyrje-daljeve për arsyen e lëvizjes gjatë orarit zyrtar të punës, sikurse parashikohet në “*Rregulloren gjatë orarit të punës*”, të institucionit, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, rregullore e cila përveç se gjendet e afishuar në ambientet e institucionit, u është dërguar në rrugë elektronike gjithë pjesëtarëve të stafit.

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, neni 40, “*Kohëzgjatja e punës, lejet dhe pushimet*”, pika 2, parashikon se, Këshilli i

Ministrave miraton rregullat për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit, për orët shtesë, kompensimin e tyre, si dhe kompensimin e shpenzimeve të kryera për ushtrimin e detyrës jashtë vendit normal të punës.

Në plotësim të këtij detyrimi ligjor, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 24.10.2002, *“Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”*, i ndryshuar, përcakton në mënyrë të detajuar në kreun I të tij, kohëzgjatjen dhe orarin zyrtar të punës për administratën publike, i cili fillon çdo ditë në orën 8:00 dhe përfundon në orën 16:30, ndërsa ditën e premte fillon në orën 8:00 dhe përfundon në orën 14:00.

Më tej, në zbatim të këtij parashikimi ligjor, institucioni Agjencia Kombëtare e Turizmit në *“Rregulloren gjatë orarit të punës”*, në fuqi, ka përcaktuar të njëjtin orar zyrtar pune, ndërsa sa i takon lëvizjes së punonjësve ka sanksionuar se çdo lëvizje kryhet me leje të eprorit të drejtpërdrejtë, duke u evidentuar kjo në librin e hyrje-daljeve, dhe duke vënë në dijeni për lëvizjen, Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme.

Gjithashtu, në ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në seksionin detyrimet e nëpunësit civil, neni 45, në pikën 2 të tij sanksionon se, nëpunësi civil ka detyrimin të shfrytëzojë kohën e punës me efikasitet dhe vetëm për kryerjen e detyrave të tij.

Në rastin konkret, referuar librit të hyrje-daljeve të punonjësve në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit, rezulton se, në datë 18.06.2020, punonjësja ******, ka hyrë në ambientet e institucionit në orën 08:04, dhe nuk rezulton e regjistruar lëvizja jashtë institucionit e përmendur nga ankuesja në orën 11:50 të kësaj dite, gjithashtu për këtë lëvizje të saj jashtë ambienteve të institucionit gjatë orarit zyrtar të punës, nuk është vënë në dijeni as sektori i Financës dhe Shërbimeve të Brendshme, sikurse parashikohet në *“Rregulloren gjatë orarit të punës”* të institucionit, çka nënkupton mos respektimin e parashikimeve ligjore dhe nënligjore në lidhje me shrytëzimin dhe lëvizjen gjatë orarit zyrtar të punës, nga ana e nëpunëses *****.

Gjithashtu, sipas përgjigjes së sjellë nga institucioni Agjencia Kombëtare e Turizmit, kjo sjellje jo korrekte e nëpunëses ******, është vërejtur edhe herë të tjera, në shumë raste kësaj nëpunëseje i është tërhequr vëmendja për shkak të pengesave të sjella nga ana e saj në mbarëvajtjen e procesit të punës, qoftë përmes e-mailit ashtu edhe në formë shkresore përmes aktit nr. 263 prot., datë 05.06.2020, me objekt: *“Komunikim i masës “Tërheqje vëmendje”*”, dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm.

Në vlerësim të akteve ligjore dhe nënligjore është me vend të theksohet se, pavarësisht që në këtë rast arsyetohet se është vepruar në zbatim të rregullores së brendshme të institucionit, duhet ti tërhiqet vëmendja njësisë së burimeve njerëzore dhe drejtuesve të tjerë të njësive organizative, që rregullorja e brendshme dhe detyrimet e tjera që parashikon

legjislacioni i shërbimit civil, duhet të zbatohen në harmoni dhe proporcion të drejtë me respektimin e rregullave të etikës në administratën publike dhe të drejtat e nëpunësit civil, duke mos lejuar cënimin e ndjenjës së dinjitetit të nëpunësve.

Në përfundim, nga gjithë sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se pretendimi i ankueses *****, për cënimin e integritetit fizik, moral dhe dinjitetit, nga ana e drejtuesve të institucionit Agjencia Kombëtare e Turizmit, nuk është i bazuar në ligj, por nga ana tjetër të mbahet parasysht vërejtja për njësitë menaxheriale, siç është përmendur në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të ankesës nr. 558 prot., datë 23.06.2020, të paraqitur nga nëpunësja *****, për shkelje të të drejtave të nëpunësit civil, përmes cënimit të integritetit fizik, moral dhe dinjitetit, nga ana e drejtuesve të institucionit Agjencia Kombëtare e Turizmit, pasi nuk u konstatuan shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë shërbimin civil.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha